



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER OSMAN RROSHI
ADRESA Rruga Jurgen Trade, Kavaje
TEL: 0697033900

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 3787

Kavaje më 02/07/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024014280129230453

Akt Themelimi

I Shoqerise Tregtare " GL " SH.P.K.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare dhe te ligjit Nr.131/2015 per "Qendren Kombetare te Biznesit" dhe formalitetet qe duhem respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, Ne, themeluesit Z.Giorgio Francesco Alunni, me nr.Karte identiteti CA93227JO, lindur me 07.08.1978 dhe banues ne Via A.Costa , N.141 Pesaro (PU) Itali dhe Z.Leonardo Romagnoli, me nr.karte identiteti CA49993GU, i datelindjes 01.11.1984, banues ne Via Lungomare N. Sauro, N.S Pesaro (PU) Itali, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin " GL " SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Sot me date 02/07/2024, formohet shoqeria tregtare private e quajtur " GL " SH.P.K. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Synej , Njesia Administrative Synej, Bashkia Kavaje, ndodhur ne zonen kadastrale nr.3554 , pasuria me numer 88/3 , volumi 4 , faqe 233. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve te saj.

Objekti i Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Tregtim dhe shitje me shumice dhe pakice te orendive per shtepi dhe zyra, aksesoreve te arredimit, mobiljeve , elektroshtepiake, aparateve radiotelevizive, makinerive dhe pajisjeve ne pergjithesi, makinerive dhe pajisjeve sportive per palestren, peshengritjen, veshjeve sportive dhe teknike, pronave per perdorim rezidencial dhe komercial, makina dhe kamione, si dhe tregtimin dhe shitjen me pakice te produkteve ushqimore dhe farmaceutike dhe suplementeve ne te gjitha format e saj, menaxhimin e pasticerive, akulloreve, bareve, piceri dhe ne pergjithesi biznese te hapura per publikun edhe gjate nates per furnizim me pije dhe ushqime, palestra, ambiente sportive, pishina, sherbime dhe konsulence te trajnimit personal, konsulence per plane ushqimore dhe stervitore, konsulence mobilimi, sherbim montimi i mobiljeve dhe pajisjeve, shitje dhe marketing, edhe online, te produkteve kozmetike, per kujdesin dhe higjenen personale, kremerat dhe parfumet, sherbimet dhe trajtimet e bukurise, masazhet,

menaxhimin e qendrave te bukurise, parukerive per meshkuj dhe femra, konsulence estetike dhe mireqenie personale, konsulence mbi kirurgjiine estetike dhe jo estetike...etj.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkak.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 200.000 lekë (dyqind mijë) Lekë.

Kapitali i Shoqerise eshte i ndare ne 2 pjese (kuota), me vlere 100.000 (njqind mije) leke secili.

Ortaku Giorgio Francesco Alunni : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njqind mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku Leonardo Romagnoli: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njqind mije) leke, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Z.Giorgio Francesco Alunni, i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Gjate votimit te Asamblese, ne rast barazimi, mbizoteron vota e Administratorit dhe percakton miratimin ose mosmiratimin e rezolutes.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Neni 9

2

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Durres.


Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Anetaret deklarojne se te gjitha komunikimet, duke perfshire edhe thirrjen e mbledhjes mund te behen permes PEC , ose ekuivalentit ose e-mail, ne vecanti anetaret deklarojne se kane e-mail/PEC ne vijim, ku duhet te adresohen komunikimet:

Per Giorgio Alunni:

Per Leonardo Romagnoli:



Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise " GL " SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket.

Akti ju perkthye paleve ne gjuhen italiane nga shtetasi KEVIN ÇAÇA i dt.05.09.1999, lindur ne Kavaje, me nr.personal identifikimi J90905045A, i cili nenshkruan ne akt me kete cilesi.

Ortakët themelues:

GIORGIO FRANCESCO ALUNNI

LEONARDO ROMAGNOLI

Perktheu:

Kevin Çaço

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER OSMAN RROSHI



V2024014280129230453

DATE 02/07/2024
NR REP 3787



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 02.07.2024, para meje Noter OSMAN RROSHI, anëtar në Dhomën Kombëtare të E Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Kavaje, Rruga Jurgen Trade, Kavaje, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES: Giorgio Francesco Alunni, shtetas Italian, lindur në Torino dhe banues në Torino me adresë Torino, lindur më 07/08/1978, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. CA93227JO dhe nr. personal CA93227JO.

NËNSHKRUES: Leonardo Romagnoli, shtetas Italian, lindur në Rancagua (CHL) dhe banues në ITALI, me adresë Itali, lindur më 01/11/1984, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. CA49993GU dhe nr. personal CA49993GU.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Akt themelimi i shoqërisë "GL" shpk.", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
OSMAN RROSHI